REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM

Nr. _____Prot.

Përmet, 21/10/2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Përmet

I nderuar këshilltar,

Ju njoftoj se ditën e Martë, datë 27.10.2026, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë, zhvillohet mbledhja e radhës, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. P/V "Për miratimin e sasisë së karburantit për automjetet, të naftës dhe të gazit të lëngshëm për ngrohjen e kopshteve të Bashkisë Përmet dhe të njësive administrative, për automjetet e MZSH-së, automjetet e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit, lëvizjen e punonjësve të shërbimit pyjor, mjetet e Bordit të Kullimit dhe mjetet e punës për rrugët rurale."
3. P/V "Për miratimin e menuve dhe të kuotës ushqimore për ofrimin e vakteve ushqimore në kuadër të projektit 'Përqafimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë', për vitin 2027."
4. P/V "Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Ministrisë së Mjedisit, në kuadër të projektit 'Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse, Deti Blu (Care 4 Blue Sea)'."
5. P/V "Për miratimin në parim të projektit 'Përmet 360 gradë Digital Heritage Experience' dhe të fondeve të bashkëfinancimit."
6. P/V "Mbi përfundimin e procedurave në zbatim të VKM-së nr. 329, datë 22.05.2019, 'Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi dhe për lidhjen e kontratave para noterit', për dy familje."
7. P/V "Për ndryshimin e vendimit nr. 87, datë 30.10.2023, të Këshillit Bashkiak, 'Për zgjedhjen e kryetarëve të kryesive të fshatrave të Bashkisë Përmet'."
8. P/V "Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, deri në masën 6%."
9. P/V "Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin tetor 2026."
10. P/V "Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për dhënien e ndihmës financiare."
11. Raportim mbi problematikat dhe veprimtarinë në njësitë administrative Çarshovë, Petran, Piskovë dhe Frashër.
12. Të tjera….

Kryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet
Anila DHIMITRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET